



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 16 datë 06/03/1995

MBI
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE DHE PERFITIMIN E
PAAFTESISE PER MUAJIN DHJETOR 1994.

Në zbatim të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, VKM Nr.453, dt.26.09.1994 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, V.K.M. Nr.557, dt.21.11.1994 “Për një ndryshim në VKM Nr.453, dt.26.09.1994”, V.K.M. Nr.138, dt.31.03.1994 “Për kompesimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, V.K.M. Nr.311, dt.11.07.1994 “Për përfitimin e paaftësisë”, udhëzimeve Nr.14, 15, Nr.1118/1 prot.të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot me dt.06.03.1995, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Seksionit të Përkrahjes Sociale

V E N D O S I

1. Të miratohet kërkesa për bllokndihmën për tre mujorin e parë të vitit 1995 me shifrën **128.000 mijë lekë** gjithsej.
2. Të miratohet masa e ndihmës për çdo familje për muajin dhjetor 1994 sipas shkresës së datës 21.12.1994 dërguar gjithë njësive administrative dhe relacionit.
3. Për muajin dhjetor 1994 të përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej **12.748 familje** me një fond prej **28.452 mijë lekë** nga të cilët

Me ndihmë të plotë **12.240 familje** me një fond prej **27.815 mijë lekë**.
Me ndihmë të pjesshme **508 familje** me një fond prej **637 mijë lekë**.

Për këto familje të jepen **6.988 mijë lekë** për kompesimin e energjisë elektrike.

4. Të miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje për muajin Janar 1995 sipas relacionit dhe shkresës dt.21.02.1995 dërguar gjithë njësisive administrative.
5. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **975 persona** të paaftë me një fond prej **1.662 mijë lekë**.
6. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike **140 familje** sipas pasqyrave të bashkangjitura dhe nga të cilët Shkëlqim Tartari dhe Shaban Sinani të gjobiten me trefishin e shumës së marrë padrejtësisht.

KRYETARI

BESNIK PETRELA